



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK1	Nr. Prot.	03-02/4257/16
Dep.		Prot. No.	
Nr. i faq.	02	Data	14.11.2016
Eroj shtesa		Datumi	
Nr. pages			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.11.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-3378-16 për z. Raif Çavolli-Ish Drejtor i Klinikës Kardio-Kirurgjike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për shkak se ai tashmë ka dhënë dorëheqje nga pozita e Drejtorit të Klinikës dhe nuk është me në mesin e zyrtarëve të lartë publik.

III. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-3378-16, për Zyrtarin e lartë, z. Raif Çavolli- Ish Drejtor i Klinikës Kardio Kirurgjike në QKUK, dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Çavolli është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Çavolli është deklaruar se ai tashmë nuk ushtron funksion të zyrtarit të lartë sepse ka dhënë dorëheqje nga pozita e Drejtorit të Klinikës Kardio-kirurgjike në QKUK.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka plotësuar edhe Formularin e Deklarimit të pasurisë pas mbarimit të funksionit publik (DPK/Dpki-03-02/4979/16) duke deklaruar se ai tani nuk ushtron funksion publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Shajir Haxholli /

